

---

# **Rregullore e Brendshme**

## **Instituti i Shendetit Publik**

### **2014**

**KREU I**  
**BAZA LIGJORE, OBJEKTI DHE FUSHA E ZBATIMIT**

**Neni 1**  
**Dispozita të Përgjithshme**

- a) Instituti i Shëndetit Publik është person juridik publik, i cili vepron në bazë të Kushtetutës, të legjislacionit shqiptar në fuqi, në veçanti në bazë të ligjit Nr.10 138, datë 11.5.2009, “Për Shëndetin Publik”, ligjit Nr. 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës” i ndryshuar, ligjit Nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, urdhrave, udhëzimeve dhe akteve të tjera nënligjore
- b) Veprimtaria e ISHP-së zhvillohet mbi bazën e parimeve të pavarësisë, paanësisë, profesionalizmit dhe konfidencialitetit.
- c) Kjo Rregullore zbatohet drejtpërdrejt prej secilit punonjës, me përjashtim të rasteve të veçanta, kur Titullari i institucionit çmon se duhet vepruar ndryshe, por kurdoherë në përputhje me ligjin.
- d) Pranimi, transferimi, dhënia e masave disiplinore apo largimi nga detyra e punonjësve të institucionit, bëhet sipas procedurave të përcaktuara në “Kodin e Punës” në “Kontratën Kolektive të Punës” dhe në këtë Rregullore.
- e) I gjithë stafi i institucionit duhet të sigurojë sekretin e të dhënave dhe konfidencialitetin e procedurave që ata ndjekin apo marrin dijeni, për shkak të funksionit dhe kompetencave të tyre kontrolluese edhe pas përfundimit të funksionit.

**Neni 2**  
**Objekti dhe Fusha e Zbatimit**

- a) Rregullorja për veprimtarinë dhe funksionimin institucional ka për qëllim të përcaktojë rregullat, detyrat e hollësishme të organizimit dhe funksionimit të strukturave dhe punonjësve që ushtrojnë aktivitetin në Institutin e Shëndetit Publik.
- b) Të gjithë punonjësit e ISHP-së janë të detyruar të zbatojnë me përpikmëri Kushtetutën, ligjet dhe aktet nënligjore.

**Neni 3**  
**Struktura dhe Organika**

- a) Për kryerjen e veprimtarisë dhe për realizimin e funksioneve të tij, Instituti i Shëndetit Publik funksionon sipas strukturës organizative të miratuar nga Ministri i Shëndetësisë me Nr.220/1 Prot, datë 17.02.2014:

## **KREU II DREJTORIA**

### **Neni 4 Drejtori**

Drejtori është drejtuesi ekzekutiv i të gjithë veprimtarisë së Institutit të Shëndetit Publik.

- a) Drejtori drejton, organizon dhe kontrollon gjithë veprimtarinë e ISHP-së, sipas strukturës dhe organikës të miratuar nga Ministria e Shëndetësisë.
- b) Drejtori vepron në bazë të legjislacionit shqiptar në tërësi, dhe në veçanti në bazë të ligjit për shëndetin publik.
- c) Në zbatim të përgjegjësiave dhe kompetencave, nxjerr urdhra, udhëzime dhe akte të tjera administrative.
- d) Drejtori ka të drejtën e emërimit dhe marrjes së masave disiplinore apo të largimit nga detyra për të gjithë punonjësit sipas procedurave të përcaktuara në “Kodin Punës”, “Kontratën Kolektive të Punës” dhe në këtë Rregullore.
- e) Marrëdhëniet e ISHP-së me Institucionet Kushtetuese, Institucionet Qendrore apo Vendore brenda dhe/ose jashtë vendit, realizohen vetëm nga Drejtori, e në mungesë të tij nga njeri prej nëndrejtorëve të autorizuar prej tij.
- f) Emërimi dhe lirimi i Drejtorit të ISHP-së bëhet nga Ministri i Shëndetësisë.

### **Neni 5 Asistenti i Drejtorit**

- a) Asistentja organizon dhe siguron dorëzimin e të gjitha dokumenteve të Drejtorit në mënyrë të plotë dhe të rregullt.
- b) Evidenton, regjistron dhe organizon realizimin e axhendës së përditshme të Drejtorit.
- c) Organizon dhe siguron rregullsinë e hyrjes së të gjitha materialeve informative për Drejtorin.
- d) Në bashkëpunim me punonjësin e informacionit duhet të koordinojë dhe të krijojë mundësinë e pritjes së personave që kërkojnë takim pune me Drejtorin.
- e) Regjistron dhe kujton çdo ditë Drejtorin për aktivitetet e ndryshme ku ai ka ftesë për pjesëmarrje, dhe e vë në dijeni në lidhje me ngjarjet dhe eventet e ndryshme.
- f) Nëpërmjet Sektorit të Protokoll-Arkivës, pret dhe nis gjithë korrespondencën personale të Drejtorit, si dhe korrespondencën e ISHP-së.

### **Neni 6 Nëndrejtori Teknik**

- a) Nëndrejtori Teknik bashkërendon aktivitetin shkencor të ISHP-së nëpërmjet bashkërendimit të punës ndërmjet departamenteve shkencore të ISHP-së, ushtron kontroll dhe kërkon llogari nga shefat përkatës, dhe ndihmon ata në zgjidhjen e problemeve.
- b) Bashkërendon punën me organizmat/organizatat donatore për realizimin e projekteve dhe kontrollon zbatimin e tyre.
- c) Mban përgjegjësi për mbarëvajtjen e punës dhe raporton para Drejtorit për departamentet që mbulon në lidhje me realizimin e detyrave të ngarkuara.

- d) Njihet me të gjitha materialet e departamenteve që mbulon, kontrollojnë nëse janë sipas kërkesave, jep vlerësim për çështjet e trajtuara dhe i miraton ato.
- e) Merr informacion nga juristi për aktet ligjore dhe nënligjore, urdhrat dhe udhëzimet e Ministrisë së Shëndetësisë apo organeve të tjera qendrore, dhe ia përcjell për njohje dhe zbatim stafit të ISHP-së.
- f) Përgatit materialet që do të bëhen të njohura publikisht, sigurohet për saktësinë e informacioneve të nevojshme në masmedia lidhur me veprimtarinë e ISHP-së.
- g) Promovon dhe nxit kapacitetet analitike të Institutit të Shëndetit Publik, në funksion të ofrimit të më shumë shërbimeve për subjektet publike dhe private.
- h) Ndjek nga ana administrative dhe siguron respektimin e marrëdhënieve ndërinstucionale gjatë procesit të ofrimit të shërbimeve për të tretët.
- i) Monitoron nga ana administrative programet dhe projektet në shërbim të ministrive të tjera.
- j) Monitoron dhe planifikon, në bashkëpunim me departamentet, shërbimet që kryen ISHP-ja në funksion të strukturave rajonale të shëndetit publik.

Drejtori i ISHP-së i delegon Nëndrejtorit Teknik edhe detyra të tjera sipas rastit dhe nevojave të institucionit.

## **Neni 7 Nëndrejtori Ekonomik**

Nëndrejtori Ekonomik ka për detyrë:

- a) Të mbështesë Drejtorin e ISHP-së dhe departamentet përkatëse në përcaktimin e strategjive të institucionit, vlerësimin e mundësive specifike dhe garantimin e qëndrueshmërisë financiare të tij.
- b) Të asistojë dhe të administrojë fondet buxhetore së bashku me Drejtorin, bazuar në analizën e nevojave të departamenteve të institutit.
- c) Të funksionojë si anëtar i ekipit të menaxhimit, nëpërmjet pjesëmarrjes në diskutime dhe kontributit krijues në proceset e menaxhimit, dhe kryesisht në mbështetjen e ofruar për departamentet brenda ISHP-së.
- d) Të drejtojë procesin e hartimit të buxhetit vjetor për ISHP-në, dhe të mbështesë Drejtorin e ISHP-së në argumentimin e tij pranë Ministrisë së Shëndetësisë.
- e) Të drejtojë procesin e analizës financiare vjetore, duke garantuar saktësinë e të dhënave financiare dhe rregullimet në buxhetin e vitit.
- f) Të përgatisë raporte për Ministrinë e Shëndetësisë, dhe të garantojë përputhshmëri me ligjshmërinë financiare.
- g) Të mirëmenaxhojë fondet buxhetore dhe të donatorëve në zbatim të legjislacionit përkatës në fuqi.

Drejtori i ISHP-së i delegon Nëndrejtorit Ekonomik edhe detyra të tjera sipas rastit dhe nevojave të institucionit.

## **KREU III DEPARTAMENTI I SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

### **Neni 8**

Departamenti i Shërbimeve Mbështetëse ka si mision:

- a) Drejtimin, koordinimin, kontrollin dhe ndjekjen e aktivitetit ekonomik dhe financiar të ISHP-së, në bashkëpunim me Titullarin e institucionit dhe Nëndrejtorin Ekonomik.
- b) Formulimin e politikave që lidhen me zhvillimin e Burimeve Njerëzore në ISHP, sigurimin e zbatimit të tyre dhe legjislacionit në këtë fushë në përputhje me strategjinë dhe objektivat e ISHP-së.
- c) Sigurimin e kushteve normale për punë në institucion, si dhe funksionimin normal të Arkivit dhe Protokollit.
- d) Zhvillimin dhe administrimin në mënyrë të vazhdueshme të procedurave të prokurimit që kryhen nga ISHP-ja në bashkëpunim me departamentet e tjera, në përputhje me legjislacionin për prokurimet publike.

Departamenti i Shërbimeve Mbështetëse përbëhet nga tre sektorë:

1. Sektori i Financës
2. Sektori i Burimeve Njerëzore
3. Sektori i Administratës

### **Neni 9** **Sektori i Financës**

Sektori i Financës ka për detyrë:

- a) Të drejtojë, koordinojë dhe të ndjekë veprimtarinë ekonomiko-financiare të ISHP-së në përputhje me ligjet në fuqi.
- b) Të ruajë me rigozitet të gjitha informacionet ekonomike të projekteve të ndryshme kërkimore e shkencore.
- c) Të bëjë vlerësimin financiar të programeve të ndryshme kërkimore e shkencore apo iniciativave operative.
- d) Të përgatisë nën drejtimin dhe në bashkëpunim me Nëndrejtorin Ekonomik planet financiare për programe të rëndësishme që mbulon dhe ndjek ISHP-ja.
- e) Të përfaqësojë në mënyrë dinjitoze dhe profesionale ISHP-në në marrëdhëniet me institucionet vendase apo të huaja për problemet ekonomike dhe financiare.
- f) Të mbajë dhe koordinojë ndjekjen dhe zbatimin e legjislacionit financiar në regjistrimin e librave kontabël.
- g) Të krijojë dhe të mbyllë bilancin vjetor të aktivitetit ekonomik të ISHP-së në përputhje me ligjin e kontabilitetit, ligjin e buxhetit dhe legjislacionet përkatëse në fuqi.
- h) Të ndjekë dhe të zbatojë procedurat financiare për realizimin e aktiviteteve të ndryshme në kuadër të projekteve nga donatorë të ndryshëm.
- i) Të mbajë dhe të regjistrojë veprimet dhe transaksionet financiare në librat e llogarive përkatëse (si ditarin e thesarit, regjistrimin e ditarit të arkës, ndjekjen e llogarive analitike furnitore, debitore, kreditore, regjistrimin e asetëve, etj.), në zbatim të legjislacionit përkatës në fuqi.
- j) Të menaxhojë dhe të përllogarisë pagat, sigurimet shoqërore në zbatim të legjislacionit përkatës dhe urdhrave të Përgjegjës të Zyrës së Burimeve Njerëzore dhe Drejtorit, si dhe të kryejë regjistrimet në sistemet online dhe kontabilizimin e tyre në regjistrat përkatës.

### **Neni 10** **Sektori i Administratës**

Sektori i Administratës organizon, drejton dhe përgjigjet për realizimin dhe mbarëvajtjen e punës brenda institucionit dhe ka këto detyra:

- a) Siguron ruajtjen e godinës së institucionit me shërbim roje 24 orë duke bashkërenduar punën me policinë e objekteve.
- b) Siguron rregull e qetësi brenda godinës së institucionit.
- c) Organizon, kontrollon dhe përgjigjet për të siguruar pastërti shembullore dhe mjedis të kulturuar në institucion.
- d) Organizon punën dhe përgjigjet për të siguruar gatishmërinë dhe funksionin normal të pajisjeve hidrosanitare, elektrike, elektronike, telefonike, të ngrohjes dhe mjeteve të transportit.
- e) Organizon punën dhe përgjigjet për të siguruar gatishmërinë dhe funksionin normal të mjeteve të transportit.
- f) Organizon punën dhe përgjigjet për lëvizjen e automjeteve të institucionit vetëm për qëllime pune. Për këtë, siguron dhe përgjigjet për shpërndarjen e sasive të karburantit për çdo automjet në përputhje të plotë me urdhër-shërbimet dhe programin e punës të miratuar nga Drejtori i ISHP-së.
- g) Organizon punën dhe përgjigjet për të siguruar dhe kompletuar të gjitha zyrat me pajisjet, inventarin dhe kancelaritë e domosdoshme për nevoja pune, sipas kërkesave të bëra dhe urdhrave e prokurimeve të dhëna nga Drejtori i ISHP-së.
- h) Organizon punën dhe përgjigjet për sigurinë dhe funksionim normal të mjediseve të punës në institucion. Studion dhe propozon rrugë e masa për përmirësimin e mjediseve të punës në ISHP me qëllim që të sigurohen standardet bashkëkohore.
- i) Merr masa për të siguruar mbrojtje sa më efektive të institucionit kundër zjarrit, sipas dispozitave në fuqi.
- j) Organizon punën, merr masa dhe ndërton një sistem mbrojtës për ruajtjen e shëndetit të punonjësve.
- k) Merr masa rigorozë për të siguruar në shkallën më të lartë ruajtjen e të gjitha materialeve biologjike, toksike, radioaktive, të cilësuar tepër të rrezikshme për shëndetin e punonjësve, si dhe mospërhapjen e tyre jashtë institucionit.
- l) Informon në mënyrë të vazhdueshme Drejtorin për punën e kryer dhe detyrat që dalin.

Drejtori i ISHP-së i delegon dhe detyra të tjera sipas rastit dhe nevojave të institucionit.

## **Neni 11**

### **Sektori i Burimeve Njerëzore**

Sektori i Burimeve Njerëzore organizon, drejton dhe përgjigjet për realizimin dhe mbarëvajtjen e punës brenda institucionit lidhur me personelin dhe ka këto detyra:

- a) Mban përgjegjësi për sistemimin dhe drejtimin e personelit, bën identifikimin e nevojave për personelin apo personelin e tepërt, rekrutimin, risistemimin e personelit në përputhje me legjislacionin, trajnimin e fillestarëve dhe të punonjësve të tjerë, ecurinë profesionale, motivimin e punonjësve dhe pagat, organizimin e strukturave, studion në cilën mënyrë dhe në çfarë mase mund të përmirësohen strukturat organizative dhe funksionale duke i bërë ato sa më të thjeshta, të efektshme dhe eficiente.
- b) Ka marrëdhënie ekuivalente e bashkëpunimi me të gjithë shefat e departamenteve shkencore dhe të sektorëve të tjerë të ISHP-së, ndërsa për problemet e sistemit dhe të menaxhimit të personelit, të departamenteve dhe sektorëve, ato janë në vartësi të Drejtorit

të ISHP-së, i cili ia kalon për veprime të mëtejshme Përgjegjësit të Zyrës së Burimeve Njerëzore.

- c) Ka përgjegjësi të drejtpërdrejtë për mbajtjen e gjithë dokumentacionit:
  - Libreza pune
  - Kontrata pune
  - Regjistër themeltar të punonjësve
- d) Dosje individuale për të gjithë punonjësit e ISHP-së.
- e) Përgatit projektin e organigramës, strukturat organizative duke u bazuar në misionin e përgjithshëm të ISHP-së dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
- f) Merr pjesë në hartimin e politikës shëndetësore në ISHP, zbërthen dhe ndjek zbatimin përcaktuar nga kjo politikë në fushën e personelit, drejton, planifikon trajnimet dhe ndjek ecurinë e punës së tyre.
- g) Merr pjesë në planifikimin e përgatitjes dhe trajnimit të punonjësve të rinj.
- h) Mbulon problemet e personelit të stafit të institutit në përgjithësi, drejton dhe ndjek procedurat e përzgjedhjeve të kuadrit drejtues, kryen veprimet përkatëse për lëvizjet, transferimet, emërtimin e personelit përkatës, masat administrative, etj.
- i) Mban përgjegjësi për mbarëvajtjen e të gjitha punëve brenda sektorit që mbulon, dhe duhet të njohë mirë dhe t'ua bëjë të njohur rregullat e etikës punonjësve të tjerë, dhe në mënyrë periodike të kontrollojë respektimin e tyre.
- j) Shqyrton ankesat për shkelje të etikës dhe merr masa për mënjanimin e tyre.
- k) Kontrollon periodikisht zbatimin e rregullave të etikës në përgjithësi.
- l) Merr masa për pajisjen e të gjithë punonjësve me kartën e identifikimit të institucionit, dhe kontrollon e përgjigjet që të gjithë punonjësit të zbatojnë rregulloren e brendshme për hyrje-daljet dhe lëvizjet brenda institucionit.
- m) Me miratimin e Drejtorit përcakton rregullat e hyrje-daljes për punonjësit dhe vizitorët, oraret e pritjes dhe takimet me subjekte të tjera dhe kontrollon respektimin e tyre.

#### **KREU IV**

### **DEPARTAMENTI I KONTROLLIT TË SËMUNDJEVE INFEKTIVE**

#### **Neni 12**

Departamenti i Kontrollit të Sëmundjeve Infektive është qendra kombëtare koordinuese e operativitetit për kontrollin dhe parandalimin e sëmundjeve infektive dhe zbatimin e Rregullores Ndërkombëtare të Shëndetit. Gjithashtu, është qendra kombëtare e referencës, ekspertizës në këtë fushë. Organizon dhe zbaton kërkime dhe projekte kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e diagnozës dhe kontrollit të sëmundjeve infektive.

Departamenti i Kontrollit të Sëmundjeve Infektive ushtron aktivitetin e vet në bashkëpunim të ngushtë me departamentet e tjera të ISHP-së dhe me Shërbimet Epidemiologjike (përfshirë Laboratorët Mikrobiologjik të Shëndetit Publik) të rretheve.

Departamenti është i organizuar në shtatë sektorë dhe përbëhet nga:

1. Sektori i Survejancës Kombëtare të Sëmundjeve Infektive
2. Sektori i Programit Kombëtar të Vaksinimit
3. Sektori i Programit Kombëtar të HIV/AIDS
4. Sektori i Kontrollit të Vektorëve
5. Sektori i Kontrollit të Infeksioneve Spitalore
6. Sektori i Laboratorëve të Referencës Kombëtare

## 7. Sektori i Prodhimit të Antigeneve dhe Serumeve Diagnostike dhe Preparatorisë

### Neni 13

#### Drejtimet kryesore të aktivitetit të Departamentit të Kontrollit të Sëmundjeve Infektive

Drejtimet kryesore të aktivitetit të Departamentit të Kontrollit të Sëmundjeve Infektive janë:

- a) Koordinimi i Sistemit të Integruar të Survejancës të Sëmundjeve Infektive (SISSI) në Shqipëri:
  - Sistemi Madhor i Survejancës i Bazuar në Sëmundje.
  - Sistemi i Survejancës ALERT i Bazuar në Sindroma.
  - Sistemet e tjera përbërëse, të Bazuara në Rast dhe me Konfirmim Laboratorik, të shenjuar për nozologji infeksioze specifike: Poliomieliti/Paralizat Flakside Akute, Fruthi dhe Rubeola, Sindroma e Rubeolës Kongjenitale, Gripi, Infeksionet Seksualisht të Transmetueshme, Hepatitet Virale, Infeksionet Invazive nga *Haemophilus influenzae b*, Meningitet, Rotaviruset, etj.
- b) Zbulimi i hershëm dhe koordinimi i përgjigjes së shpejtë ndaj shpërthimeve epidemike. Monitorimi i hasje së shpërthimeve epidemike.
- c) Studimet epidemiologjike në fushën e sëmundjeve infektive për përcaktimin e trendit të tyre sipas triadës klasike person-vend-kohë dhe identifikimin e faktorëve rrezikues të hasjes së tyre.
- d) Menaxhimi i programit të vaksinimit duke përfshirë këtu të gjitha aspektet e tij, si monitorimi i niveleve të mbulesës vaksinore në kohë e hapësirë, futja e vaksinave të reja, adaptimi i kalendarit të vaksinimit, menaxhimi i zinxhirit të ftohtë, survejanca e reaksioneve pasvaksinore, përgatitja e strategjisë kombëtare të vaksinimit, koordinimi i regjistrit elektronik të vaksinimit, etj.
- e) Menaxhimi i programit të luftës kundër HIV/AIDS dhe IST-ve duke përfshirë këtu të gjitha aspektet, si ndjekja dhe identifikimi i rasteve, survejanca e integruar e HIV/AIDS, koordinimi i survejancës sindromike dhe laboratorike për IST-të, përgatitja e strategjive kombëtare, koordinimi i programeve specifike përfshirë edhe ato të edukimit për HIV/AIDS, etj.
- f) Menaxhimi i programit të kontrollit të vektorëve duke kryer identifikimin dhe shpërndarjen e vektorëve kryesor në vend, identifikimin e faktorëve të rrezikut, studime epidemiologjike dhe ekologjike për vektorët, koordinimin e udhëzimeve dhe trajnimin për luftën kundër vektorëve.
- g) Studime mbi habitatet/biotopet/biocenozat e vektorëve (insekte, minj) të sëmundjeve infektive me transmetim vektorial; studime mbi insekticido dhe raticidorezistencën dhe masat e kontrollit të tyre.
- h) Studime sero-epidemiologjike mbi profilet e mbrojtjes specifike pasvaksinore të popullatës ndaj sëmundjeve infektive të parandalueshme, me vaksinim dhe mbi profilet imunologjike të popullatës ndaj sëmundjeve të tjera infektive.
- i) Realizimi i diagnozës laboratorike për sëmundjet infektive me rrezikshmëri të lartë, ato që transmetohen nga vektorët dhe zoonozat.
- j) Përgatitja dhe koordinimi i strategjive dhe programeve për kontrollin dhe parandalimin e zoonozave të kontrollit dhe parandalimit veterinar (bruceloza, antraksi, leptospirozat,



listerioza, etj.) në bashkëpunim të ngushtë me shërbimin veterinar (Institutin e Kërkimeve Veterinare).

- k) Përpilimi i sistemeve të reja sëmundje-specifike përbërëse të SISSI-it, dhe koordinimi për zbatimin e tyre në praktikë.
- l) Përpilimi i udhëzimeve dhe koordinimi në fushën e diagnozës mikrobiologjike të sëmundjeve infektive.
- m) Studime në fushën e diagnozës mikrobiologjike të sëmundjeve infektive.
- n) Rritja e gamës dhe cilësisë së diagnozës mikrobiologjike në drejtim të konfirmimit laboratorik të rastit nëpërmjet aplikimit të teknikave të biologjisë molekulare, etj.
- o) Ruajtja dhe pasurimi i bankës së linjave qelizore që shërbejnë për diagnozën virologjike.
- p) Sigurimi i biosigurisë në laboratorët e ISHP-së dhe koordinimi i punës në këtë drejtim për të gjithë vendin.
- q) Qendra koordinuese kombëtare për aplikimin në vend të Rregullores Ndërkombëtare të Shëndetit: përgatitja e strategjive përkatëse dhe koordinimi ndërmjet aktorëve brenda ISHP-së, si dhe ndërmjet ISHP-së me sektorët e tjerë brenda dhe jashtë sferës së shëndetësisë për zbulimin e hershëm dhe përgjigjen ndaj situatave shëndetësore, eventualisht jo të zakonshme të shëndetit publik në Shqipëri.
- r) Qendra e zhvillimit rajonal për koordinimin e survejancës dhe kontrollit të sëmundjeve infektive për vendet e Europës Juglindore (Shqipëri, Mal i Zi, Maqedoni, Kroaci, Serbi, Rumani, Bullgari, Bosnjë dhe Hercegovinë, Moldavi, Kosovë), e cila synon të rrisë bashkëpunimin për zbulimin e hershëm dhe përgjigjen e shpejtë ndaj situatave shëndetësore, eventualisht jo të zakonshme të shëndetit publik për vendet ndërkufitare.
- s) Planizimi/organizimi/drejtimi teknik i seminareve, workshopeve, mbledhjeve teknike me punonjësit e shëndetit publik të rretheve.
- t) Përgatitja e udhëzuesve/manualeve teknike për punonjësit e shëndetit publik të rretheve.

#### **Neni 14**

##### **Spektori i Survejancës Kombëtare të Sëmundjeve Infektive**

- a) Grumbullon, përpunon, analizon në kohë dhe në vijueshmëri të dhënat mbi sëmundshmërinë infektive, të dërguara në ISHP (në Departamentin e Kontrollit të Sëmundjeve Infektive) nga Shërbimet Epidemiologjike të të gjitha rretheve të vendit, dhe ndërhyrja apo vepron në bazë të këtyre të dhënave. Burimi i të dhënave përfshin kujdesin parësor, spitalor dytësor dhe spitalor tretësor, si në shërbimin publik dhe atë privat.
- b) Vlerëson çdo ngjarje të pazakontë në vend dhe, në bashkëpunim edhe me departamentet e tjera të ISHP-së apo struktura të tjera, njofton menjëherë drejtorinë e ISHP-së, Ministrinë e Shëndetësisë dhe OBSH-në, dhe realizon të gjitha ndërhyrjet ndaj shpërthimeve epidemike apo situatave jo të zakonshme në vend apo rajon, duke përmbytur funksionet e tij si qendër e koordinimit për Rregulloren Ndërkombëtare të Shëndetit.
- c) Ky sektor është Qendra Kombëtare e Epidemiologjisë së Sëmundjeve Infektive, duke shërbyer njëherësh edhe si bazamenti i Qendrës së zhvillimit rajonal për koordinimin e survejancës dhe kontrollit të sëmundjeve infektive.

#### **Neni 15**

##### **Spektori i Programit Kombëtar të Vaksinimit**

Menaxhon programin e vaksinimit duke kryer:

- a) Sigurimin në kohë dhe sasinë e duhur të të gjitha vaksinave (antigeneve) të Kalendarit Kombëtar të Vaksinimit dhe shpërndarjen periodike (çdo tremujor) të tyre në tërë rrethet e vendit.
- b) Monitorimin e ecurisë së Programit Kombëtar të Vaksinimit.
- c) Monitorimin e niveleve të mbulesës vaksinore për secilin antigen të Kalendarit Kombëtar të Vaksinimit.
- d) Sigurimin e zinxhirit ftohës dhe monitorimin e performancës së tij.
- e) Organizimin/zhvillimin e fushatave të vaksinimit për të siguruar mbulesë të lartë vaksinore në çdo komunitet.
- f) Nxitjen për përdorimin e teknologjisë së informacionit apo mënyra të tjera për të siguruar një nivel mbrojtjeje vaksinore në kohë dhe të lartë në shërbim të qytetarëve.
- g) Monitorimin e reaksioneve pasvaksinore (efekteve anësore të padëshirueshme të vaksinës/vaksinimit) në bashkëpunim me Sektorin e Survejancës Kombëtare të Sëmundjeve Infektive të këtij Departamenti (ISHP) dhe Qendrën Kombëtare të Kontrollit të Barnave.

Ky sektor monitoron punën e sektorëve përkatës në DSHP-të në rrethe apo në sektorë të tjerë publik dhe privat që lidhen me vaksinimin. Ai kryen ndërhyrje që përmirësojnë programin e vaksinimit dhe efektivitetin e tij.

### **Neni 16**

#### **Spektori i Programit Kombëtar të HIV/AIDS**

- a) Ky sektor është struktura përgjegjëse në shkallë vendi (i) e survejancës së gjeneratës së parë (dikur) dhe gjeneratës së dytë (aktualisht) të HIV/AIDS, (ii) e kryerjes periodikisht të studimeve përkatëse epidemiologjike të tipit YRBS (Youth Risky Behaviour Survey) dhe Bio-BSS (Biological and Behavioural Surveillance Survey) të bazuara njëherësh në grupet në rrezik të lartë dhe në popullatën e përgjithshme, (iii) e epidemiologjisë së HIV/AIDS dhe monitorimit të rasteve HIV/AIDS.
- b) Ky program ka për detyrë të përgatisë apo të vlerësojë raporte dhe programe kombëtare, dhe të marrë pjesë në ato ndërkombëtare për HIV/AIDS.
- c) Vlerëson të gjitha ndërhyrjet që kryhen në fushën e HIV/AIDS në vend dhe nxit ndërhyrje të reja efikase.

### **Neni 17**

#### **Spektori i Kontrollit të Vektorëve**

Ky sektor është struktura përgjegjëse për studimet në entomologjinë mjekësore dhe rodentologjinë mjekësore, objektivi kryesor i të cilave është:

- a) Përfitimi në dinamikë i hartave të biocenozone-biotopeve-habitateve të vektorëve.
- b) Identifikimi taksonomik i vektorëve.
- c) Përcaktimi i pranisë dhe nivelit të rezistencës së insekteve-vektorë ndaj insekticideve (insekticido-rezistenca) dhe brejtësve-rezervuarë ndaj raticideve (raticido-rezistenca).

### **Neni 18**

#### **Spektori i Kontrollit të Infeksioneve Spitalore**

Ky sektor është struktura përgjegjëse për studimet dhe monitorimin e infeksioneve nozokomiale në shërbimin spitalor në të gjithë vendin. Komponentë organik të objektivit të mësipërm janë aspektet e dezinfektimit (efikasiteti/efektiviteti i dezinfektantëve dhe metodave/technikave të dezinfektimit) dhe antibiotiko-rezistencës.

Detyrat kryesore të këtij sektori konsistojnë në:

- a) Zhvillimin dhe përditësimin e standardeve për kontrollin dhe parandalimin e infeksioneve nozokomiale në shërbimin spitalor në të gjithë vendin.
- b) Kryerjen e ekspertizës dhe vlerësimin e infeksioneve nozokomiale në shërbimin spitalor në të gjithë vendin.
- c) Realizimin e studimeve për përcaktimin e prevalencës dhe faktorëve shkaktarë të infeksioneve nozokomiale në shërbimin spitalor në të gjithë vendin.
- d) Monitorimin e vazhdueshëm të infeksioneve nozokomiale në shërbimin spitalor në të gjithë vendin.
- e) Vlerësimin e antibiotiko-rezistencës.

### **Neni 19**

#### **Spektori i Laboratorëve të Referencës Kombëtare**

Ky sektor është struktura e referencës dhe ekspertizës në diagnostikën mikrobiologjike në fushën e shëndeti publik në Shqipëri.

Spektori i laboratorëve është i organizuar në disa laboratorë dhe konkretisht:

1. **Laboratorët e Virologjisë**
2. **Laboratori i Imunologjisë (HIV/AIDS dhe Hepatiteve Virale)**
3. **Laboratorët e Bakteriologjisë dhe Mykologjisë**
4. **Laboratorët e Parazitologjisë**
5. **Laboratori i Biologjisë Molekulare**

Detyrat kryesore të laboratorëve të këtij sektori konsistojnë në:

- a) Zhvillimin dhe përditësimin në sasi dhe cilësi të diagnostikës laboratorike dhe realizimin e kërkesave përkatëse të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (Rajoni Europian) lidhur me certifikimin periodik të tyre prej kësaj Organizate, apo organizmave të tjera ndërkombëtare.
- b) Kryerjen e ekspertizës diagnostike në shkallë vendi.
- c) Ndihmesën në etiologjinë e shpërthimeve epidemike, studimet e mirëfillta mikrobiologjike.
- d) Studimet epidemiologjike/sero-epidemiologjike në bashkëpunim të ngushtë me sektorët e tjerë përbërës të këtij departamenti dhe me departamentet e tjera të ISHP-së, si dhe sigurimin e biosigurisë në ISHP dhe në të gjithë vendin.

### **Neni 20**

#### **Spektori i Prodhimit të Antigeneve dhe Serumeve Diagnostike dhe Preparatorisë**

- a) Ka për detyrë prodhimin e antigeneve dhe serumeve diagnostike, për nevoja të ISHP-së dhe laboratorëve mikrobiologjik të rretheve.
- b) Përgatit terrenet kulturore për nevojat e laboratorëve të ISHP-së.

- c) Monitoron dhe siguron cilësinë e diagnozës bakteriologjike në të gjithë laboratorët mikrobiologjik të shëndetit publik të vendit, nëpërmjet vlerësimeve të cilësisë dhe monitorimit të standardeve dhe protokolleve të miratuara.

**KREU V**  
**DEPARTAMENTI I SHËNDETTIT DHE MJEDISIT**  
**Neni 21**

Departamenti i Shëndetit dhe Mjedisit ushtron aktivitetin e vet në bashkëpunim të ngushtë me departamentet e tjera shkencore të ISHP-së, Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, drejtoritë/shërbimet e shëndetit publik në bazë rajoni/rrethi, si dhe sektorët publik jashtë sferës së shëndetësisë dhe/ose organizma/organizata të ndryshme jopublike brenda dhe jashtë vendit.

Departamenti i Shëndetit dhe Mjedisit është i organizuar në gjashtë sektorë:

1. Sektori i Ujit dhe Sanitetit
2. Sektori i Epidemiologjisë Ambientale dhe Kontrollit të Cilësisë së Ajrit
3. Sektori i Fizikës Sanitare
4. Sektori i Shëndetit në Punë dhe Toksikologjisë
5. Sektori i Ushqyerjes dhe Sigurisë Ushqimore
6. Sektori i Laboratorëve

**Neni 22**  
**Drejtimet Kryesore të Aktivitetit të Departamentit të Shëndetit dhe Mjedisit**

Departamenti i Shëndetit dhe Mjedisit është qendra referencë kombëtare për çështjet e lidhura me ujin e pijshëm, cilësinë e ajrit, sigurinë ushqimore, fizikën sanitare dhe të gjitha çështjet e tjera të lidhura me shëndetin dhe mjedisin. Qëllimi final i të gjithë veprimtarisë së këtij departamenti është përmirësimi i qëndrueshëm dhe mbrojtja e shëndetit të popullatës nga kërcënimet mjedisore.

Drejtimet kryesore të aktivitetit të Departamentit të Shëndetit dhe Mjedisit janë:

- a) Ekspertiza në fushën e ujit dhe sanitetit përmes studimeve shkencore lidhur me vlerësimin e rrezikut.
- b) Ekspertiza në fushën e cilësisë së ajrit përmes monitorimit të vazhdueshëm, si dhe ndërmarrjes së studimeve të thelluara shkencore.
- c) Ekspertiza në fushën e higjienës së vendeve të banuara, me planifikimin e qyteteve dhe fshatrave, me problemet e materialeve ndërtimore të banesave.
- d) Ekspertiza në fushën e sigurisë ushqimore përmes hulumtimeve shkencore periodike.
- e) Ekspertiza në mbrotjen e popullatës nga zhurmat dhe vibracionet, si agjentë rreziku për shëndetin mendor dhe më gjerë.
- f) Ekspertiza në fushën e fizikës sanitare.

**Neni 23**  
**Seksioni i Ujit dhe Sanitetit**

- a) Seksioni i Ujit dhe Sanitetit, si qender reference shkencore e kërkimeve në fushën e ujit dhe sanitetit, ka për detyrë të bëjë studime dhe hulumtime në lidhje me vlerësimin e rreziqeve mjedisore të dëmshme që lidhen me ujin dhe sanitetin, impakti në shëndet.
- b) Organizon kontrollin e gjendjes teknike të veprave me karakter sanitar (kaptazhe, depo, linja të jashtme dhe të brendshme të ujësjellësit) dhe gjendjen e sistemit të kanalizimeve.
- c) Kryen studime në fushën e higjienës së vendeve të banuara, me planifikimin e qyteteve dhe fshatrave, me problemet e materialeve ndërtimore të banesave etj.
- d) Propozon dhe punon në vazhdimësi në lidhje me përmirësimin e legjislacionit, standardeve dhe normave duke patur parasysh përafrimin e tij me legjislacionin e BE-së.
- e) Ofron ndihmë tekniko-profesionale për specialistët e shëndetit publik, shërbimit të higjienës dhe Inspektoriatit Sanitar Shtetëror në rrethe, ofron trajnimin dhe kualifikimin e specialistëve të shërbimit të higjienës dhe ISSH-së në rrethe me anë të seminareve dhe pranë seksionit në fushën e ujit dhe sanitetit, merr pjesë në to.
- f) Ndjek në mënyrë të vazhdueshme dhe mban nën kontroll të vazhdueshëm situatën higjieno-sanitare të ujit të pijshëm në vend nëpërmjet analizës së të dhënave që vijnë nga rrethet, bën vlerësimin e faktorëve të rrezikut në lidhje me monitorimin e ujit të pijshëm.
- g) Përgatit në mënyrë periodike (muajore) Buletinin e Ujit të Pijshëm dhe e dërgon atë në institucionet qendrore dhe në të gjitha DSHP-të e rretheve.
- h) Përgatit në vazhdimësi informacione shkencore në fushën e ujit dhe sanitetit për dikastere të ndryshme shtetërore qendrore dhe lokale me qëllim informacioni, sensibilizimi dhe vëmendjeje më të madhe ndaj problemeve të ujit të pijshëm nga ana e tyre, me qëllim reduktimin e ekspozimit të popullatës ndaj faktorëve të dëmshëm që lidhen me ujin e pijshëm.
- i) Organizon, studion dhe merr masa për zbatimin e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit, mbi monitorimin e ujit të pijshëm dhe ujërave sipërfaqësore, në bashkëpunim dhe të ofruar nga donatorë të huaj, vendas, sipas vendimit Nr. 103, datë 31.03.2002.
- j) Organizon dhe kontrollon punën për marrjen e masave të nevojshme për seksionin, me qëllim funksionimin në mënyrë të rregullt e të shpejtë të të gjitha kërkesave emergjente që paraqiten në lidhje me ujin e pijshëm.
- k) Organizon punën për shpërndarjen e mostrave të ujërave në të gjithë laboratorët e departamentit. Harton treguesit analitik për secilin laborator, bashkëpunon dhe konsultohet me specialistë të ndryshëm, mikrobiologë dhe kimistë, për probleme të ndryshme në lidhje me rezultatet analitike.
- l) Përgjigjet në kohë për të gjitha kërkesat e bëra nga subjekte shtetërore dhe private për ekzaminime laboratorike dhe vlerësime analitike të ujërave. (Përgatitja e raport-analizave të ndryshme në lidhje me këtë problem dhe futja e të ardhurave dytësore nga të tretët).
- m) Mbledh të dhënat analitike nga të gjithë laboratorët, përgatit dokumentacionin për hartimin e raport-analizave dhe informacioneve të tjera nga kuadri i lartë.

## **Neni 24**

### **Sektori i Fizikës Sanitare**

Qëllimi i punës së këtij sektori është njohja dhe zbatimi i ligjshmërisë së shëndetit publik me fokus fizikën sanitare, në fushat e ndotjes akustike, vibracioneve, valëve elektromagnetike e rrezatimeve të tjera, etj., për vlerësimin e ekspozimit dhe ndikimit në shëndetin e popullatës dhe punëmarrësve, nëpërmjet monitorimit, vlerësimit dhe ekspertizës analitiko-shkencore.

Përgatitja e akteve ligjore e nënligjore në fushën e fizikës sanitare dhe trajnimi i specialistëve të shëndetit publik për ekspertizën sanitare, monitorimin dhe vlerësimin praktik-shkencor.

Detyrat e Sektorit të Fizikës Sanitare:

- a) Nëpërmjet zbatimit të ligjshmërisë dhe monitorimit, vlerësimit dhe ekspertizës sanitare të arrihet njohja e situatës së ndotjes nga faktorët fizik në mjediset e hapura dhe të mbyllura.
- b) Vlerësimi i ndikimit në shëndetin e popullatës dhe punëmarrësve nga faktorë të ndryshëm fizik.
- c) Organizimi dhe kryerja e ekspertizave sanitare për vlerësimin e ndotjes akustike dhe elementeve të tjera të fizikës sanitare.
- d) Përgatitja dhe trajnimi i specialistëve të shëndetit publik në fushën e fizikës sanitare.
- e) Përgatitja e materialeve shkencore përmbledhëse në fushën e ekspozimit ndaj faktorëve fizik në popullatë dhe ndikimit në shëndet.
- f) Bashkëpunimi me strukturat e tjera qendrore e vendore në fushën e fizikës sanitare.
- g) Bashkëpunimi dhe bashkërendimi i veprimtarisë me rrjetin e institucioneve të tjera të shëndetit publik, për monitorimin, vlerësimin dhe ekspertizën në fushën e fizikës sanitare.

## **Neni 25**

### **Sektori i Epidemiologjisë Ambientale dhe Kontrollit të Cilësisë së Ajrit**

Ky sektor ka për detyrë:

- a) Të realizojë vlerësimin e impaktit që ka ndotja e cilësisë së ajrit në shëndetin e popullatës.
- b) Të marrë pjesë në ekspertizat sanitare që lidhen me ndotjen urbane dhe impaktin që ka kjo ndotje në popullatë.
- c) Të hartojë dhe të realizojë tema studimore lidhur me problemet shëndetësore që lidhen me ndotjen (cilësia e ajrit të brendshëm dhe të jashtëm) nëpërmjet bashkëpunimit edhe me laboratorët e tjerë.
- d) Të mbajë dokumentacione të rregullta në lidhje me aktivitetet e kryera dhe raportimin e tyre pranë shefit të departamentit.
- e) Të realizojë tema seminaresh me specialistë të fushës në lidhje me implementimin e indikatorëve të mjedisit dhe shëndetit (kryesisht cilësia e ajrit) për të dalë më mirë në pah lidhja shkak-pasojë.
- f) Të ketë njohuri të standardeve që lidhen me treguesit e ndotjes së cilësisë së ajrit.

## **Neni 26**

### **Sektori i Laboratorëve**

Ky sektor është struktura e referencës dhe ekspertizës në diagnostikën mikrobiologjike në fushën e shëndetit publik në Shqipëri.

Laboratorët janë të organizuar si më poshtë:

1. **Laboratori i Mikrobiologjisë së Ushqimeve dhe Mykologjisë**
2. **Laboratori i Mikrobiologjisë së Ujit, Ajrit, Tokës**
3. **Laboratori i Kimisë së Ujit dhe Sanitetit**
4. **Laboratori i Kimisë së Ushqimeve dhe Përcaktimi i Jodit në Urinë**

## 5. Laboratori i Kimisë Analitike Instrumentale dhe Sigurisë dhe Kontrollit të Cilësisë

### Neni 27

#### Laboratori i Mikrobiologjisë së Ushqimeve dhe Mykologjisë

Detyrat e këtij laboratorit janë:

- a) Të survejojë situatën e prodhimeve ushqimore nëpërmjet studimeve të ndryshme në fushën e mikrobiologjisë ushqimore në bashkëpunim me laboratorët e tjerë kimik dhe toksikologjik të kësaj fushe, me qëllim përmirësimin e sigurisë ushqimore, për mbrojtjen e konsumatorit në përputhje me standardet e BE-së, dhe mbi impaktin e tyre në shëndetin e komunitetit.
- b) Të përpunojë metoda dhe të përmirësojë vazhdimisht teknikën e punës laboratorike.
- c) Të marrë pjesë në ekspertiza, në raste intoksikacionesh ushqimore.
- d) Të analizojë prodhimet e reja ushqimore për parastandarde.
- e) Të analizojë mostrat e ushqimeve për të tretë në bazë të kërkesave të subjekteve të ndryshme.
- f) Të jetë përgjegjës për rezultatin e analizave mikrobiologjike dhe dokumentacionin që lidhet me të.
- g) Të ndihmojë në përpilimin e normave, udhëzimeve dhe rregulloreve me karakter higjieno-sanitar në fushën e mikrobiologjisë së ushqimeve, si dhe të bëjë sugjerime për normat sanitare ekzistuese.
- h) Të organizojë shfrytëzimin racional të kohës së punës, mirëmbajtjen e përdorimit racional të aparaturave, reagentëve dhe mjeteve të konsumit.
- i) Të mbajë të gjitha dokumentacionet që pasqyrojnë anën teknike të veprimtarisë së laboratorit.
- j) Të planifikojë kërkesat mujore e vjetore për reagentë, kite, terrene, qelqurina etj.

### Neni 28

#### Laboratori i Mikrobiologjisë së Ujit, Ajrit, Tokës

- a) Ky laborator është përgjegjës për menaxhimin e teknikave laboratorike me të cilat punon, për mirëmbajtjen e pjesëve, kalibrimin e metodave, furnizimin me pjesë ndërrimi e materiale konsumi (lajmëron shefin e laboratorëve për defektet dhe nevojat për mirëmbajtje për teknikat laboratorike).
- b) Duhet të pajiset me certifikatë për përdorimin e aparaturave dhe teknikave speciale me të cilat punon.
- c) Gjatë trajnimit për një teknikë të caktuar duhet të jetë nën supervizionin e një personeli me eksperiencë dhe të trajnuar më parë.
- d) Të hartojë PSP (procedurat standarde të punës) për analizat që mbulon.
- e) Të ndihmojë në përlllogaritjen e kostos së analizave të reja, së bashku me financierët e ISHP-së.
- f) Të hartojë kërkesat periodike për mjete ndihmëse, reagentë, qelqurina, pjesë këmbimi, materiale konsumi etj., për analizat dhe teknikat që mbulon, dhe t'ia paraqesë shefit të seksionit të laboratorëve.
- g) Të ndihmojë shefin e laboratorëve për hartimin e kërkesave vjetore për reagentë, kite, qelqurina, pjesë këmbimi etj.

- h) Të mbajë dokumentacion të rregullt për teknikat dhe për rezultatet e analizave të kryera sipas GLP-së (praktikës së mirë laboratorike,) dhe standardit ISO 17025.
- i) Të mbështesë seksionet e ndryshme të departamentit duke i furnizuar me analiza të substancave gjurmë (metale të rënda, mikrondotës organik si pesticide klororganike, hidrokarbure etj.), të aprovuara nga bordi drejtues i ISHP-së për mostrat ushqimore, mjedisore dhe biologjike.
- j) Të mbështesë me analiza kimike për treguesit e aprovuar, në rastin e ekspertizave dhe emergjencave për shëndetin publik.
- k) Të zhvillojë punë kërkimore për shtrimin dhe futjen e metodikave bashkëkohore të analizave.
- l) Të jetë përgjegjës për përpunimin e mostrave (përgatitjen, pastrimin, koncentrimin) dhe analizimin sipas metodikave të aprovuara (standarde ose jo), si dhe për validimin e metodave analitike me të cilat punon.
- m) Të shkruajë raport-analizat në funksion të rezultateve dhe rekomandimet ose vërejtjet që mund të lidhen me ndonjë konstatim të vërejtur në mostër, dhe t'i firmosë ato.
- n) Ndalohet marrëdhënia direkte e analistëve me klientët, si për marrje mostre ashtu edhe për dhënie përgjigje të rezultateve të analizave.
- o) Të ruajë konfidencialitetin e rezultateve të analizave.
- p) Të jetë përgjegjës për menaxhimin e mostrave në nivel laboratorik, (ruajtjen para dhe pas analizës dhe dokumentimin).
- q) Të mbajë dokumentacion të rregullt mbi gjithë aktivitetin e laboratorit sipas rregullave të pranuar.
- r) Të kujdeset për evadimin e rregullt të mbeturinave të dëmshme të analizave sipas rregullave ndërkombëtare për mbrojtjen e mjedisit.
- s) Të hartojë programe trajnimi dhe të organizojë kurse specializimi dhe rifreskimi për kimistët e rretheve, që të mbajë në koherencë rrjetin kombëtar të laboratorëve të shëndetit publik.
- t) Të marrë pjesë në kontrollin e punës së laboratorëve të rretheve.
- u) T'i transmetojë njohuritë e tij/saj pjesëtarëve të tjerë të ekipit analitik (si për kuadrot e lartë, ashtu edhe për teknikët apo laborantët, përfshi edhe udhëheqjen e temave të diplomave universitare).
- v) Në rast largimi të përhershëm nga vendi i punës, kimisti dorëzon me inventar të rregullt gjithë materialet teknike, aparaturat për të cilat ka qenë përgjegjës, dokumentacionin përkatës (instruksione përdorimi, mirëmbajtje, SOP etj.), si dhe materialet didaktike, artikujt shkencor, botimet, informacionet (në arkiv të ISHP-së) etj. që ka kryer gjatë kohës së punës në laborator.

## **DETYRAT E PERSONELIT TË MESËM NË LABORATORIN MIKROBIOLOGJIK**

- a) Njeh dhe zbaton rregulloren e brendshme të laboratorit të mikrobiologjisë (sigurimin teknik, metodat e punës, etj.) dhe përgjigjet për punën e kryer në laborator.
- b) Kryen procedurat e punës sipas ndarjes së punës që bëhet nga shefi i laboratorit dhe merret me mirëmbajtjen e laboratorit (përgatitje në terren, sterilizime, mirëmbajtje laborator, etj.), duke përgatitur të gjitha materialet e nevojshme për kryerjen e analizave mikrobiologjike.



- c) Merr pjesë në mbajtjen e regjistrimit e mostrave, regjistrin e rezultateve të analizave rutinore dhe studimore.
- d) Merr pjesë në furnizimin e vazhdueshëm të laboratorit me materialet ndihmëse e të konsumit.
- e) Kryen të gjitha analizat mikrobiologjike të mostrave mjedisore, të ujërave që vijnë në laborator, duke zbatuar me përpikmëri procedurat teknike të analizës.
- f) Mban në gjendje gatishmërie të gjitha aparaturat e laboratorit.
- g) Zhdëmton materialet infekte, sipas rregullave të asepsisë dhe sterilizimit.
- h) Menaxhon reagentët dhe qelqurinat duke mbajtur dokumentacionin përkatës.
- i) Mirëmban materialet biologjike që janë në ruajtje (kultura mikrobike, shtame, etj.) duke etiketuar çdo gjë me llojin e materialit, datën e pasazhimit, datën e përdorimit ose datën e asgjësimit të tyre.

### **Neni 29**

#### **Laboranti i Kimisë së Ujit dhe Saniteti**

- a) Njeh dhe zbaton rregulloren e brendshme të laboratorëve (sigurimin teknik, metodat e punës, etj.) dhe përgjigjet përpara përgjegjësit të laboratorit për punën e kryer.
- b) Merr pjesë në temat studimore të laboratorit si në kryerjen e analizave mikrobiologjike edhe në përpunimin e rezultateve.
- c) Kryen procedurat e punës sipas ndarjes së punës që bëhet nga shefi i laboratorit dhe merret me mirëmbajtjen e laboratorit.
- d) Mban regjistrin e mostrave, regjistrin e rezultateve të analizave rutinore dhe studimore.
- e) Siguron furnizimin e vazhdueshëm të laboratorit me materialet ndihmëse e të konsumit.
- f) Kryen të gjitha analizat mikrobiologjike të mostrave të ujërave dhe mostrave të tjera mjedisore (ujë, ajër tokë) që vijnë në laborator duke zbatuar me përpikmëri procedurat teknike të analizës, si dhe aplikimin e metodave të reja të futura në laborator.
- g) Përgatit të gjitha materialet e nevojshme për kryerjen e analizave mikrobiologjike.
- h) Mban në gjendje gatishmërie të gjitha aparaturat e laboratorit, si dhe aparatit e prodhimit të ujit të dejonizuar dhe bidistile për të gjithë laboratorët e departamentit.
- i) Kryen sterilizimin e materialeve të domosdoshme për kryerjen e analizave mikrobiologjike si zhdëmtim të materialeve infekte, sipas rregullores së asepsisë.
- j) Menaxhon reagentët dhe qelqurinat duke mbajtur dokumentacionin përkatës.
- k) Mirëmban materialet biologjike që janë në ruajtje (kultura mikrobike, shtame, etj.) duke etiketuar çdo gjë me llojin e materialit, datën e pasazhimit, datën e përdorimit ose datën e asgjësimit të tyre.

## **KREU VI**

### **DEPARTAMENTI I EPIDEMIOLOGJISË DHE SISTEMEVE SHËNDETËSORE**

#### **Neni 29**

Departamenti i Epidemiologjisë dhe Sistemeve Shëndetësore ushtron aktivitetin e vet në bashkëpunim të ngushtë me departamentet e tjera shkencore të ISHP-së, Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, drejtoritë/shërbimet e shëndetit publik në bazë rajoni/rrethi, si dhe

sektorët publik jashtë sferës së shëndetësisë dhe/ose organizma/organizata të ndryshme jopublike brenda dhe jashtë vendit.

Departamenti i Epidemiologjisë dhe Sistemeve Shëndetësore është i organizuar në katër sektorë:

1. Sektori i Observatorit Epidemiologjik
2. Sektori i Epidemiologjisë të Sëmundjeve Kronike dhe Kërkimi mbi Politikën Shëndetësore
3. Sektori i kërkimit në Popullatë
4. Zyra Kombëtare e Sistemit të Informimit për Drogat

### **Neni 30**

#### **Drejtimit Kryesore të Aktivitetit të Departamentit të Epidemiologjisë dhe Sistemeve Shëndetësore**

Departamenti i Epidemiologjisë dhe Sistemeve Shëndetësore është qendra kombëtare në fushën e shëndetit publik për prodhimin e indikatorëve shëndetësor, kontrollin dhe parandalimin e sëmundjeve kronike joinfektive, epidemiologjinë e shëndetit riprodhues, studimin/kërkimin mbi sistemet shëndetësore, studimin dhe monitorimin e problematikës së drogës në Shqipëri. Ai ka për funksion të kryejë kërkime kualitative dhe kuantitative në ndihmë të politikave dhe strategjive të shëndetit, të monitorojë dhe vlerësojë impaktin e ndërhyrjeve në fushën e shëndetit publik, të nxisë/mbështesë koordinimin ndërinstytucional, dhe të kontribuojë në forcimin e kapaciteteve në fushat e menaxhimit, planifikimit dhe ekonomisë shëndetësore, me synim mbrojtjen e shëndetit të popullatës dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve në shëndetësi.

Drejtimit kryesore të aktivitetit të Departamentit të Epidemiologjisë dhe Sistemeve Shëndetësore janë:

1. Prodhimi periodik i indikatorëve të ndryshëm shëndetësor (Observatori Kombëtar Epidemiologjik), konkretisht:
  - a) Indikatorët Demografik dhe Shtesa Natyrore e Popullsisë, dhe Piramida e Popullatës.
  - b) Indikatorët (Nivelet) e Vdekshmërisë së Përgjithshme (nga të gjitha shkaqet) Krude dhe të Standardizuar në popullatën totale (të dyja gjinitë, të gjitha grup-moshat), sipas gjinisë (gjini-specifike), sipas moshës (moshë-specifike), sipas gjinisë dhe moshës (gjini-specifike dhe moshë-specifike).
  - c) Indikatorët (Nivelet) e Vdekshmërisë Krude dhe të Standardizuar sipas Shkaqeve (shkak-specifik) në popullatën totale (vdekshmëria shkak-specifik për të dyja gjinitë dhe të gjitha grup-moshat), popullatën totale sipas gjinisë (vdekshmëria gjini-specifike, shkak-specifik), popullatën totale sipas grup-moshave (vdekshmëria moshë-specifike, shkak-specifik), popullatën totale sipas gjinisë dhe grup-moshave (vdekshmëria gjini-specifike, moshë-specifike, shkak-specifik).
  - d) Indikatorët (Nivelet) e Vdekshmërisë Amësore.
  - e) Indikatorët e Vdekshmërisë Fetale: Nivelet e Vdekshmërisë Fetale; Raporti i Vdekshmërisë Fetale.
  - f) Indikatorët e Vdekshmërisë Perinatale: Nivelet e Vdekshmërisë Perinatale; Raporti i Vdekshmërisë Perinatale.
  - g) Indikatorët (Nivelet) e Vdekshmërisë Foshnjore (0-1 vjeç) për grup-moshën në total, si dhe sipas 3 ndarjeve moshore në muaj (Nivelet e Vdekshmërisë Neonatale të Hershme; Nivelet e Vdekshmërisë Neonatale të Vonshme; Nivelet e Vdekshmërisë Pas-neonatale).

- h) Indikatorët (Nivelet) e Sëmundshmërisë të Bazuar në Spital (spitalore) Krude dhe të Standardizuar në popullatën totale (të dyja gjinitë, të gjitha grup-moshat), sipas gjinisë (gjini-specifike), sipas moshës (moshë-specifike), sipas gjinisë dhe moshës (gjini-specifike dhe moshë-specifike).
  - i) Indikatorët (Nivelet) e Sëmundshmërisë të bazuar në Spital (spitalore) Krude dhe të Standardizuar sipas Shkaqeve (shkak-specifik) në popullatën totale (vdekshmëria shkak-specifik për të dyja gjinitë dhe të gjitha grup-moshat), popullatën totale sipas gjinisë (vdekshmëria gjini-specifike, shkak-specifik), popullatën totale sipas grup-moshave (vdekshmëria moshë-specifike, shkak-specifik), popullatën totale sipas gjinisë dhe grup-moshave (vdekshmëria gjini-specifike, moshë-specifike, shkak-specifik).
  - j) Indikatorët (Nivelet) e Sëmundshmërisë të Bazuar në Shërbimin Parësor Krude dhe të Standardizuar në popullatën totale (të dyja gjinitë, të gjitha grup-moshat), sipas gjinisë (gjini-specifike), sipas moshës (moshë-specifike), sipas gjinisë dhe moshës (gjini-specifike dhe moshë-specifike).
  - k) Indikatorët (Nivelet) e Sëmundshmërisë të bazuar në Shërbimin Parësor Krude dhe të Standardizuar sipas Shkaqeve (shkak-specifik) në popullatën totale (vdekshmëria shkak-specifik për të dyja gjinitë dhe të gjitha grup-moshat), popullatën totale sipas gjinisë (vdekshmëria gjini-specifike, shkak-specifik), popullatën totale sipas grup-moshave (vdekshmëria moshë-specifike, shkak-specifik), popullatën totale sipas gjinisë dhe grup-moshave (vdekshmëria gjini-specifike, moshë-specifike, shkak-specifik).
  - l) Indikatorët e Rritjes së Popullatës dhe Lindjes së Gjallë: Nivelet e Rritjes së Popullatës; Nivelet e Fertilitetit të Pergjithshëm; Nivelet e Shtatzënisë së Përgjithshme; Nivelet Moshë-Specifike të Fertilitetit; Nivelet e Fertilitetit Total.
  - m) Indikatorët e Ndërprerjes së Induktuar të Shtatzënisë (Aborteve): Nivelet e Ndërprerjes së Induktuar të Shtatzënisë; Raporti I i Ndërprerjes së Induktuar të Shtatzënisë; Raporti II i Ndërprerjes së Induktuar të Shtatzënisë.
  - n) Indikatorët e Shërbimit dhe Menaxhimit Spitalor.
  - o) Indikatorët e Shërbimit/Kujdesit Shëndetësor Parësor.
  - p) Indikatorët e Aksesit në Shërbimet Shëndetësore (Parësor, Spitalor).
2. Studime mbi Epidemiologjinë dhe Kontrollin e Sëmundjeve Kronike dhe mbi Politikat Shëndetësore Përkatëse (Sektori i Sëmundjeve Kronike Joinfektive dhe Kërkimit mbi Politikat Shëndetësore), konkretisht:
- a) Studime në popullatë mbi faktorët e rrezikut të sëmundjeve kronike (përparësi sëmundjet kario-cerebro-vaskulare, kanceri, diabeti, sëmundjet pulmonare kronike).
  - b) Analiza epidemiologjike mbi shpërndarjen dhe frekuencën e hasjes konform triadës klasike epidemiologjike person-vend-kohë të sëmundjeve kronike.
  - c) Studime mbi kapacitetet, nevojat dhe nivelet e performancës profesionale të shërbimeve shëndetësore në fushën e sëmundjeve kronike.
  - d) Analiza mbi nivelet e aksesit të popullatës në shërbimet shëndetësore në fushën e sëmundjeve kronike.
  - e) Ndërtim dhe menaxhim i sistemeve tëurvejancës specifike të sëmundjeve të ndryshme kronike (përparësi sëmundjet kario-cerebro-vaskulare, kanceri, diabeti, sëmundjet pulmonare kronike) dhe shërbimeve përkatëse të kontrollit.
  - f) Monitorim dhe vlerësim i strategjive/politikave të kontrollit për sëmundjet kronike.

- g) Përgatitje e materialeve trajnuese/instruktuese në fushën e parandalimit parësor (edukim dhe promocion shëndetësor), parandalimit dytësor (kapja e hershme e rasteve nëpërmjet depistimit), dhe parandalimit tretësor (cilësia e kujdesit përkatës mjekësor në drejtim të trajtimit adekuat) për sëmundjet kronike.
  - h) Përgatitje e udhëzuesve/manualeve teknike për punonjësit e shëndetit publik të rretheve.
  - i) Pilotim modelesh të kontrollit të sëmundjeve kronike në nivel qendror dhe nivel lokal, bazuar në praktikat më të mira.
  - j) Mbështetje/koordinim lidhur me politikat dhe strategjitë e reja në fushën e kontrollit të sëmundjeve kronike nëpërmjet organizimit të seminareve, workshopeve, konferencave shkencore.
3. Studime në fushën e Epidemiologjisë së Shëndetit Riprodhues dhe Epidemiologjisë së Shëndetit Mendor (Sektori i Kërkimit në Popullatë), konkretisht:
- a) Qendra Kombëtare e Sistemit të Survejancës së Abortit në Shqipëri: grumbullimi nga të gjitha burimet përkatëse i të dhënave mbi abortet, analiza periodike e tyre, monitorimi (nëpërmjet operativitetit në terren) i ecurisë së sistemit të survejancës (identifikimi dhe eliminimi i bias-eve eventualisht të pranishëm), përpilimi i raporteve shkencore, përditësimi i aspekteve të ndryshme të objektivave përbërëse të strategjisë përkatëse.
  - b) Qendra Kombëtare e Sistemit të Survejancës së Defekteve të Lindura në Shqipëri: grumbullimi nga të gjitha burimet përkatëse i të dhënave mbi defektet e lindura (keqformimet kongjenitale), analiza periodike e tyre, monitorimi (nëpërmjet operativitetit në terren) i ecurisë së sistemit të survejancës (identifikimi dhe eliminimi i bias-eve eventualisht të pranishëm), përpilimi i raporteve shkencore, përditësimi i aspekteve të ndryshme të objektivave përbërëse të strategjisë përkatëse.
  - c) Programi Kombëtar LMIS mbi kontrceptivët: planifikimi në bazë të nevojave të të gjitha rretheve të vendit në sasi dhe sipas asortimenteve, shpërndarja, dhe monitorimi mbi përdorimin e tyre.
  - d) Studime epidemiologjike mbi aspekte të ndryshme të Planifikimit Familjar në Shqipëri.
  - e) Studime epidemiologjike mbi Sëmundshmërinë dhe Vdekshmërinë Foshnjore (0-1 vjeç) në Shqipëri.
  - f) Studime epidemiologjike mbi Sëmundshmërinë dhe Vdekshmërinë Fëmijërore (1-4 vjeç) në Shqipëri.
  - g) Studime epidemiologjike mbi Sëmundshmërinë dhe Vdekshmërinë Amësore në Shqipëri.
  - h) Studime epidemiologjike mbi Shëndetin Mendor në Shqipëri.
4. Qendra Kombëtare e Informacionit për Drogat:
- a) Grumbullimi periodik i informacionit për drogat nga të gjitha burimet ekzistuese lidhur me kërkesën për drogë dhe ofertën për drogë.
  - b) Përgatitja nga Grupi Kombëtar i Ekspertëve i Raporteve periodike Kombëtare mbi situatën e drogës (përdorimi, drogë-vartësia, shpërndarja/trafikimi) në Shqipëri, konform udhëzimeve dhe kërkesave standarde përkatëse të EMCDDA (European Center of Drugs and Drug Addiction – Qendra Europiane e Drogës dhe Drogë-Vartësisë).

**Neni 31**  
**Sektori i Observatorit Epidemiologjik**

Ky sektor është përgjegjës për prodhimin periodik të indikatorëve shëndetësor bazuar në të dhënat që merren periodikisht nga INSTAT (të dhënat demografike, të dhënat mbi vdekshmërinë, lindshmërinë, etj.), nga Ministria e Shëndetësisë (të dhënat mbi sëmundshmërinë spitalore, menaxhimin spitalor, etj.), nga Instituti i Sigurimeve dhe Kujdesit Shëndetësor (të dhënat mbi sëmundshmërinë ambulatorë, menaxhimin e kujdesit shëndetësor parësor, etj.), nga Departamenti i Kontrollit të Sëmundjeve Infektive të ISHP-së (të dhënat e grumbulluara dhe të analizuar nga ai Departament mbi sëmundshmërinë infektive), nga Departamenti i Mjedisit dhe Shëndetit të ISHP-së (të dhënat e grumbulluara dhe analizuar nga ai Departament mbi monitorimin e ujit të pijshëm, monitorimin e determinantëve të tjerë rrezikues mjedisor), si dhe burime të tjera brenda e jashtë fushës së shëndetësisë.

### **Neni 32**

#### **Spektori i Epidemiologjisë së Sëmundjeve Kronike dhe Kërkimi mbi Politikat Shëndetësore**

Ky sektor është përgjegjës për studimin mbi kontrollin e sëmundjeve kronike joinfektive, bazuar në survejancën dhe studimin epidemiologjik, me fokus të veçantë në identifikimin dhe monitorimin e faktorëve/determinantëve rrezikues.

Mbi bazën e të dhënave të përftuara mbi studimin mbi shkakësinë dhe rrjedhojat përkatëse, si dhe të dhënat e lartpërmendura mbi sëmundshmërinë dhe vdekshmërinë të grumbulluara nga Observatori Kombëtar Epidemiologjik, ai realizon kërkimin mbi politikat shëndetësore në vendin tonë në fushën e sëmundjeve kronike (sëmundjet kardio-cerebro-vaskulare, kanceri, diabeti, sëmundjet pulmonare kronike, etj.).

### **Neni 33**

#### **Spektori i Kërkimit në Popullatë**

Ky sektor është përgjegjës për studimin e aspekteve të ndryshme të Epidemiologjisë së Shëndetit Riprodhues, të tilla si:

- (i) Shëndeti i Nënës dhe Fëmijës (sëmundshmëria dhe vdekshmëria foshnjore, fëmijërore <5 vjeç, amtare)
- (ii) Survejanca e Abortit
- (iii) Survejanca e Defekteve të Lindura
- (iv) Planifikimi Familjar (Programi LMIS mbi kontraktivët)
- (v) Shëndeti i Gruas: moshat riprodhuese, menopauza, pas-menopauza, si dhe aspekteve të Epidemiologjisë së Shëndetit Mendor

### **Neni 34**

#### **Zyra Kombëtare e Sistemit të Informimit për Drogat**

Kjo zyrë është përgjegjëse për grumbullimin periodik të të dhënave për drogën (i) nga burimet e ndryshme të kërkesës për drogë, dhe (ii) burimet e ndryshme të ofertës për drogë. Mbi bazën e të dhënave të grumbulluara nga kjo qender, Grupi Kombëtar i Ekspertëve për Drogën realizon

prodhimin e indikatorëve epidemiologjik të reduktimit të kërkesës për drogë dhe atyre të reduktimit të ofertës, që përbëjnë bazamentin e Raportit Kombëtar Vjetor të Drogës të përpiluar nga ai Grup, konform udhëzimeve dhe kërkesave standarde përkatëse të EMCDDA (European Center of Drugs and Drug Addiction – Qendra Europiane e Drogës dhe Drogë-Vartësisë).

## **KREU VII**

### **DEPARTAMENTI I INFORMACIONIT SHËNDETËSOR, TEKNOLOGJISË DHE KOMUNIKIMIT**

#### **Neni 35**

Departamenti i Informacionit Shëndetësor, Teknologjisë dhe Komunikimit ka si mision grumbullimin, unifikimin dhe analizën e të gjitha të dhënave dhe informacionit shëndetësor, përdorimin dhe diseminimin e strategjive efektive dhe bashkëkohore të komunikimit dhe informimit shëndetësor, me qëllimin final përmirësimin e cilësisë së kujdesit shëndetësor, e reflektuar kjo në rritje dhe përmirësim të qëndrueshëm të rezultateve dhe tregueseve shëndetësor të popullatës së vendit. Është pikërisht ky Departament, ku përmbahet nga ana organike dhe funksionale “Magazina e të Dhënave” (“*Data Warehouse*”) e Sistemit të Informacionit Shëndetësor të Shqipërisë

Departamenti i Informacionit Shëndetësor, Teknologjisë dhe Komunikimit ushtron aktivitetin e vet në bashkëpunim të ngushtë me departamentet e tjera shkencore të ISHP-së, Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, drejtoritë/shërbimet e shëndetit publik në bazë rajoni/rrethi, si dhe sektorët publik jashtë sferës së shëndetësisë dhe/ose organizma/organizata të ndryshme jopublike brenda dhe jashtë vendit.

Departamenti përbëhet nga tre sektorë:

1. Sektori i Zhvillimit të Teknologjisë dhe Informacionit
2. Sektori i Indikatorëve Shëndetësor
3. Sektori i Botimeve

#### **Neni 36**

### **Drejtimit Kryesore të Aktivitetit të Departamentit të Informacionit Shëndetësor, Teknologjisë dhe Komunikimit**

Drejtimit kryesore të aktivitetit të Departamentit të Informacionit Shëndetësor, Teknologjisë dhe Komunikimit janë:

- a) Grumbullimi periodik i informacionit shëndetësor mbi sëmundshmërinë spitalore nga baza e të dhënave (database) e Ministrisë së Shëndetësisë.
- b) Kontrolli mbi sasinë dhe cilësinë e informacionit të grumbulluar.
- c) Monitorimi dhe përditësimi i *website* të ISHP-së lidhur me informacionet e prodhuara periodikisht nga departamentet shkencore të ISHP-së.
- d) Informimi dhe komunikimi i informacionit shëndetësor në të gjitha nivelet, përfshirë politikë-bërësit dhe vendim-marrësit, ekspertët dhe profesionistët e sektorit shëndetësor, shoqërinë civile dhe publikun në tërësi.

- e) Prodhimi periodik i Buletinit Shkencor të Institutit të Shëndetit Publik, që përfaqëson kanal kryesor të komunikimit dhe diseminimit të informacionit shëndetësor të profesionistëve të shëndetësisë dhe të gjithë aktorët dhe faktorët e sektorit të shërbimeve shëndetësore në nivel lokal dhe kombëtar, përfshirë edhe agjencitë, organizmat dhe institucionet ndërkombëtare që asistojnë dhe mbështesin zhvillimin dhe përsosjen e sistemit të shërbimeve shëndetësore në Shqipëri.
- f) Prodhimi periodik i Revistës Mjekësore (në shqip) dhe Albanian Medical Journal (homologu në anglisht) përfaqëson mediumin e shkruar shkencor më të rëndësishëm (krahas njëherësh me Buletinin e Shkencave Mjekësore të Fakultetit të Mjekësisë, Universiteti i Tiranës) në fushën e shëndetësisë në vendin tonë. Kjo revistë përfaqëson kanal kryesor të komunikimit të rezultateve të projekteve kërkimore-shkencore në fushën e shëndetësisë, në arenën kombëtare dhe ndërkombëtare.
- g) Prodhimi periodik i materialeve të tjera informuese: shoqëria civile dhe opinioni publik në tërësi informohen rreth aktiviteteve dhe indikatorëve kryesor të shëndetit të popullatës përmes kanaleve të tjera alternative të komunikimit të tilla si postera, fletë-palosje, apo komunikata për shtyp.
- h) Mbështetja ndaj Qendrës Kombëtare të Edukimit në Vazhdim (QKEV) lidhur me edukimin në vazhdim në fushën e shëndetit publik.
- i) Mbështetja për Drejtorinë e ISHP-së lidhur me përpilimin e dokumentacionit përkatës në projekte studimore të bashkëpunimit dhe partnershit të ISHP-së me institucione të ndryshme, brenda dhe jashtë vendit në fushën e shëndetit publik.

### **Neni 37**

#### **Sektori i Zhvillimit të Teknologjisë së Informacionit**

Ky sektor përfaqëson qendrën kombëtare të grumbullimit të informacionit shëndetësor, si dhe të studimit, kërkimit, ekspertizës dhe trajnimit në fushën e administrimit dhe menaxhimit të informacionit shëndetësor “Magazina e të Dhënave” “Data Warehouse”. Në bashkëpunim të ngushtë me Observatorin Kombëtar Epidemiologjik (Departamenti i Epidemiologjisë dhe Sistemeve Shëndetësore), si dhe me departamentet e tjera të ISHP-së, ky sektor kryen analizën statistikore të të dhënave të ndryshme të informacionit shëndetësor.

### **Neni 38**

#### **Sektori i Indikatorëve Shëndetësor**

Ky sektor ushtron aktivitetet e mëposhtme:

- a) Analizën statistikore të të dhënave të informacionit të grumbulluar.
- b) Grumbullimin periodik të informacionit shëndetësor mbi aspektet e ndryshme të aktivitetit spitalor nga baza e të dhënave (database) e Ministrisë së Shëndetësisë. Kontrollin mbi sasinë dhe cilësinë e informacionit të grumbulluar.
- c) Analizën statistikore të të dhënave të informacionit të grumbulluar.
- d) Grumbullimin periodik të informacionit shëndetësor që përmbahet në Pasqyrat e tjera (përveç atyre të lidhura me sëmundjet infektive) nga baza e të dhënave (database) e Ministrisë së Shëndetësisë.
- e) Grumbullimin periodik të informacionit shëndetësor që përmbahet në bazën e të dhënave (database) të Institutit të Sigurimeve dhe Kujdesit Shëndetësor (ISKSH) lidhur me:

- Sëmundshmërinë në shërbimin e kujdesit shëndetësor parësor.
  - Aspektet e ndryshme të aktivitetit dhe performancës profesionale të shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor.
  - Kontrolli mbi sasinë dhe cilësinë e informacionit të grumbulluar.
  - Analiza statistikore e të dhënave të informacionit të grumbulluar.
- f) Studimet/kërkimet në fushën e administrimit dhe menaxhimit të informacionit shëndetësor me synim optimalizimin e treguesve përkatës.
- g) Ekspertizën dhe trajnimet në fushën e administrimit dhe menaxhimit të informacionit shëndetësor me personelin shëndetësor përkatës në bazë rajoni dhe/ose rrethi në tërë vendin.
- h) Monitorimin dhe mbështetjen teknike mbi operativitetin funksional të rrjetit të brendshëm kompjuterik të ISHP-së, dhe ndërkëmbimin e informacionit ndërmjet strukturave përbërëse të ISHP-së.

### **Neni 39**

#### **Sektori i Botimeve**

Përfaqëson qendrën kombëtare të informimit dhe komunikimit të informacionit shëndetësor në të gjitha nivelet, përfshirë politikë-bërësit dhe vendim-marrësit, ekspertët dhe profesionistët e sektorit shëndetësor, shoqërinë civile dhe publikun në tërësi. Ai përfaqëson po ashtu qendrën kombëtare në fushën e shëndetit publik të raportimit shkencor të situatës dhe treguesve shëndetësor në popullatën e vendit përmes publikimeve periodike shkencore.

## **KREU VIII**

### **DEPARTAMENTI I EDUKIMIT DHE PROMOCIONIT SHËNDETËSOR**

#### **Neni 40**

Misioni i Departamentit të Edukimit dhe Promocionit Shëndetësor (DEPSH) është të përmirësojë shëndetin e njerëzve nëpërmjet rritjes së kontrollit mbi shëndetin. Nëpërmjet edukimit shëndetësor, njerëzve u jepet mundësia që të mësojnë rreth shëndetit të tyre dhe të ndryshojnë sjelljen e tyre. Për të realizuar misionin e tij, DEPSH-ja punon në fushat e mëposhtme si:

- Rritja e ndërgjegjësimit të njerëzve për çështjet që lidhen me shëndetin dhe faktorët që kontribuojnë në shëndet.
- Ofrimi i informacionit.
- Motivimi dhe bindja e njerëzve për të ndryshuar stilin e tyre të jetës për të përmirësuar shëndetin e tyre.
- Pajisja e njerëzve me aftësi dhe besim për t'i bërë këto ndryshime.

Departamenti i Edukimit dhe Promocionit Shëndetësor nuk përqendrohet në punën e tij vetëm tek individit, por merr në konsideratë edhe faktorët e tjerë social, ekonomik dhe politik, të cilët përcaktojnë shëndetin. Kjo sepse shëndeti është një përgjegjësi e përbashkët e gjithë shoqërisë. Mjedisi dhe veprimtaria politike është gjithashtu në fokus të këtij departamenti.

Promovimi i shëndetit kryhet nëpërmjet:

- **Advokacisë.** Ky departament kryen advokaci duke paraqitur interesat e grupeve të disavantazuara të popullatës, duke folur në interes të tyre ose duke lobuar për të influencuar politikën e ndryshme qeveritare në mbrojtje të shëndetit të këtyre grupeve.



- **Mundësimit.** Departamenti ka për qëllim të reduktojë diferencat në statusin e shëndetit dhe të sigurojë mundësi të barabarta për të gjithë njerëzit që të arrijnë plotësisht potencialin e tyre për shëndet.
- **Ndërmjetësimit.** Detyrë e departamentit është edhe koordinimi dhe bashkëpunimi ndërmjet agjencive dhe sektorëve të ndryshëm qeveritar dhe joqeveritar për të përmirësuar shëndetin e popullatës.

Departamenti është i organizuar në katër sektorë dhe konkretisht:

1. Sektori i Stilit të Jetesës
2. Sektori i Shëndetit Riprodhues
3. Sektori i Shëndetit Mendor
4. Sektori i Substancave Abuzive (duhan, alkool)

#### **Neni 41**

### **Drejtimit Kryesor të Aktivitetit të Departamentit të Edukimit dhe Promocionit Shëndetësor**

Departamenti i Edukimit Shëndetësor dhe Promocionit të Shëndetit drejton dhe udhëheq nga ana metodike, didaktike dhe shkencore punën për:

- a) Sensibilizimin e grup-moshave të ndryshme për mbrojtjen dhe forcimin e shëndetit të tyre nëpërmjet forcimit të veprimtarisë edukativo-shëndetësore (informuese, edukuese, komunikuese). Për këtë synohet :
  - Rritja e shkallës së njohurive shëndetësore të publikut rreth shkaktarëve të sëmundjeve dhe masat parandaluese ndaj tyre.
  - Ndërgjegjësimi i publikut për rolin e edukimit shëndetësor dhe promocionit të shëndetit për mbrojtjen e shëndetit në përgjithësi, dhe ndryshimin e sjelljeve të tyre.
- b) Edukimin shëndetësor të grupeve të ndryshme target dhe më konkretisht të grave shtatzëna, të nënave të reja, të fëmijëve të moshës shkolllore, të moshës së tretë etj., duke përdorur:
  - Edukimin shëndetësor si një proces i komunikimit ndërpersonal për ndryshimin e sjelljeve mbi shëndetin, pra që njerëzit të mësojnë si ta fitojnë dhe si ta ruajnë atë.
  - Promocionin e shëndetit si një proces që u krijon njerëzve mundësitë për të rritur kontrollin ndaj shëndetit të tyre dhe për ta përmirësuar atë, si një veprim i përbashkët i komunitetit.
- c) Ngritjen e nivelit teoriko-shkencor dhe metodik të punonjësve të vet si edhe të punonjësve të Shërbimit të Edukimit Shëndetësor në rrethe, nëpërmjet shfrytëzimit të dokumenteve bazë të OBSH-së, si Karta e Ottava-s, Karta Europiane për Mjedisin dhe Shëndetin, Dokumenti i Alma-Ata-s, Shëndet 2020, etj., të literaturës së gjerë bashkëkohore, shfrytëzimit të kontakteve midis specialistëve të vendit me ata të huaj, pjesëmarrjen në seminare kombëtare e ndërkombëtare, si edhe angazhimin e punonjësve në studime të drejtpërdrejta.
- d) Përgatitjen dhe organizimin e aktiviteteve të ndryshme edukativo-shëndetësore duke punuar për :
  - Përgatitjen e materialeve metodike për teorinë dhe praktikën e Edukimit Shëndetësor dhe të Promocionit të Shëndetit.
  - Përgatitjen e materialeve të ndryshme edukativo-shëndetësore si buletine, manuale, fletëpalosje, broshura, postera, spote etj.
  - Studimin e nivelit të kulturës dhe edukatës shëndetësore të publikut nëpërmjet intervistimeve, vëzhgimeve, grumbullimit të të dhënave, etj.

- Trajnimet mbi teorinë dhe praktikën e Edukimit Shëndetësor dhe Promocionit të Shëndetit, të personelit mjekësor dhe paramjekësor në të gjitha strukturat e shërbimit shëndetësor.
- Organizimin e fushatave të ndryshme sensibilizuese me rastin e evenimenteve të caktuara shëndetësore, apo edhe për probleme të ndryshme emergjente.

#### **Neni 42**

#### **Sektori i Sëmundjeve jo të Transmetueshme**

Ky sektor ka si mision nxitjen e politikave të bazuara në fakte dhe mbështetjen e përmirësimit të vazhdueshëm të sistemit të kujdesit shëndetësor në fushën e sëmundjeve jo të komunikueshme (me fokus sëmundjet kardiovaskulare dhe kanceret) duke identifikuar problemet në çështje të tilla si nevojat për shërbime dhe aksesin në shërbime, kapacitetet njerëzore dhe teknologjike, kapja e hershme dhe depistimi, monitorimi i cilësisë etj., duke ndihmuar në propozimin e zgjidhjeve të përshtatshme për vendin tonë, si dhe duke mbështetur trajnimin e personelit shëndetësor në sistemin e kujdesit parësor dhe atë të shëndetit publik.

Detyrat e Sektorit të Sëmundjeve jo të Transmetueshme:

- a) Kryen kërkime në fushën e sëmundjeve jo të komunikueshme dhe në fushën e politikave shëndetësore për to (kërkime në popullatë, në sistemet shëndetësore ose në literaturë).
- b) Mbështet Ministrinë e Shëndetësisë në procesin e përgatitjes së strategjive dhe politikave specifike për sëmundjet jo të komunikueshme.
- c) Mbështet zbatimin në praktikë të politikave të reja në fushën e kontrollit të sëmundjeve jo të komunikueshme nëpërmjet organizimit të programeve të trajnimit, seminareve, workshopeve dhe konferencave shkencore.
- d) Menaxhon sistemet e shërbimit, depistimit të sëmundjeve jo të komunikueshme duke bashkëpunuar me drejtoritë rajonale të shëndetit publik dhe institucione të tjera shëndetësore përmes programeve të monitorimit.
- e) Propozon indikatorë të monitorimit të sëmundjeve jo të komunikueshme dhe menaxhon në kuadër të departamentit sisteme tëurvejancës sistematike bazuar në sistemin shëndetësor (regjistra specifik).
- f) Skicon programe të bashkëpunimit kombëtar e ndërkombëtar, dhe koordinon punën mes partnerëve të mundshëm.
- g) Mbështet programet e arsimit në shëndet publik, në fushën e epidemiologjisë dhe kontrollit të sëmundjeve jo të komunikueshme.

#### **Neni 43**

#### **Sektori i Shëndetit Riprodhues**

Sektori i Shëndetit Riprodhues ka si mision përmirësimin e shëndetit të popullsisë shqiptare, nëpërmjet fuqizimit të saj për të marrë vendime të shëndetshme e të informuara rreth shëndetit riprodhues.

Detyrat e Sektorit të Shëndetit Riprodhues:

- a) Vlerësimi i nevojave të komunitetit për edukimin dhe promocionin shëndetësor lidhur me Shëndetin Riprodhues.
- b) Hartimi i programeve të edukimit dhe promocionit shëndetësor lidhur me Shëndetin Riprodhues.
- c) Implementimi, monitorimi dhe vlerësimi i programeve të edukimit dhe promocionit shëndetësor lidhur me Shëndetin Riprodhues.
- d) Advokimi për problematika të lidhura me Shëndetin Riprodhues.
- e) Ndërtimi i koalicioneve me partnerë të fushës së Shëndetit Riprodhues.
- f) Zhvillimi fushatave kombëtare të edukimit dhe promocionit mbi Shëndetin Riprodhues.
- g) Forcimi i kapaciteteve profesionale/edukimi në vazhdim lidhur me edukimin e promocionin e Shëndetit Riprodhues (hartimi i kurrikulave/ manuale trajnimi, trajnime, workshope, konsulencë/asistencë teknike, etj.).
- h) Zhvillimi i materialeve edukativo-shëndetësore mbi Shëndetin Riprodhues.
- i) Stimulimi dhe mbështetja e iniciativave lokale lidhur me Shëndetin Riprodhues.
- j) Kryerja e aktiviteteve shkencore (kërkime/studime, publikime, konferenca, etj) në fushën e Shëndetit Riprodhues.

#### **Neni 44**

#### **Sektori i Shëndetit Mendor**

Sektori i “Shëndetit Mendor” është sektori i cili operon në promovimin e shëndetit mendor, duke synuar hulumtimin dhe diagnostikimin e faktorëve të rrezikut të lidhur me sjelljet, në mënyrë që të parandalohen problemet në shëndetin mendor. Ky sektor punon në zbatim të Ligjit Nr. 44/2012 “Për shëndetin mendor”.

Detyrat e Sektorit të Shëndetit Mendor:

- a) Harton materiale informuese, edukuese dhe parandaluese lidhur me shëndetin mendor.
- b) Kryen studime për identifikimin dhe hulumtimin e faktorëve rrezikues të lidhur me sjelljet që ndikojnë në shëndetin mendor.
- c) Kontribuon në hartimin e dokumenteve strategjik të lidhur me shëndetin mendor.
- d) Përmirëson kualifikimin profesional në fushën e shëndetit mendor të specialistëve pjesë e këtij sektori.
- e) Organizon konferenca, trajnime, seminare, etj., lidhur me shëndetin mendor.
- f) Bashkëpunon me institucione akademike, pushtetin lokal, OJF-të në fushën e shëndetit mendor.
- g) Bashkëpunon me institucione të specializuara për shëndetin mendor të tilla si: shërbimet e kujdesit shëndetësor parësor; shërbimet komunitare të shëndetit mendor; shërbimet ambulatorë të specializuara; shërbimet e shëndetit mendor të specializuara me shtretër.

#### **Neni 45**

#### **Sektori i Substancave Abuzive (duhan, alkool)**

Sektori i Substancave Abuzive (duhan, alkool) ka si mision përmirësimin e shëndetit të popullatës nëpërmjet promovimit të stilit të jetesës së shëndetshme, larg përdorimit të substancave abuzive.

Detyrat kryesore të Sektorit të Substancave Abuzive:

- a) Harton materiale informuese, edukuese dhe parandaluese lidhur me parandalimin e substancave abuzive (duhan, alkool).
- b) Merr pjesë në hartimin e dokumenteve politike për parandalimin e përdorimit të substancave abuzive (duhan, alkool).
- c) Kryen aktivitete promovuese për parandalimin e sjelljeve të rrezikshme shëndetësore në mjedise të ndryshme (shkolla, shërbime shëndetësore, komunitet, vende pune).
- d) Kontribuon në zhvillimin e studimeve në popullatë dhe ose në grupet në rrezik për përdorimin e substancave abuzive (duhan, alkool).
- e) Zhvillon aktivitete për forcimin e kapaciteteve kombëtare në fushën e parandalimit të sjelljeve të rrezikshme shëndetësore (duhan, alkool).
- f) Bashkëpunon me institucionet e tjera shëndetësore për zbatimin e ligjit antiduhan.

#### **Neni 46** **Sektori i Vivariumit**

Ky sektor është një nga sektorët mbështetës të ISHP-së.

Detyrat e Sektorit të Vivariumit:

- a) Krijimi i kushteve optimale për rritjen dhe zhvillimin e kafshëve të laboratorit (desh, lepuj, minj, kavje, gjela).
- b) Siguria e shëndetit të kafshëve të laboratorit përmes mbrojtjes, ushqimit, vaksinimit dhe kontrollit periodik të tyre.
- c) Përgjigjja në kohë dhe me cilësi kërkesave sipas procedurave për sigurimin e punës rutinë dhe shkencore të Institutit.
- d) Bashkërendimi i punës me laboratorin e prodhimit të terreneve në marrjen e gjakut të dashit dhe gjakut të lepurit për përgatitjen e terreneve kulturore për të gjithë laboratorët në ISHP.
- e) Bashkërendimi i punës me laboratorin SAD, për furnizimin me lepuj sipas kushteve të protokollit për procedurat e prodhimit të serumeve diagnostike.
- f) Bashkërendimi i punës me laboratorin e Virologjisë përmes marrjes së gjakut të gjelit për provat e izolatit të gripit.
- g) Gjithashtu, u përgjigjet nevojave për punë shkencore përmes kafshëve eksperimentale si minj dhe kavje.

#### **Neni 47** **Sektori i Radiombrojtjes**

Sektori i Radiombrojtjes ka vartësi të dyfishtë. Ky sektor varet edhe nga ISHP-ja dhe nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet në Ministrinë e Shëndetësisë.

Sektori i Radiombrojtjes funksionon në bazë të një rregulloreje të veçantë të miratuar nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet.